

## **DRAFT PLANI KORNIZË PËR TË ADRESUAR ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR NGA KONFLIKTET NË TERRITORIN E ISH JUGOSLLAVISË**

1. Duke marrë parasysh marrëveshjet ekzistuese dypalëshe, protokollet e bashkëpunimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit dhe duke mbështetur zbatimin e tyre të plotë, ky Plan i Përbashkët kornizë synon të përshpejtojë procesin e llogaridhënjes për 12,000 personat që ende mungojnë si pasojë e konflikteve të viteve 1990 në territorin e ish-Jugosllavisë.
2. Planin do të zbatohet nga Grupi i Personave të Zhdukur (GPZH). GPZH do të përbëhet nga Institucionet Vendore (IV) të cilat janë përgjegjëse për kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur nga Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Kosova\*, Mali i Zi dhe Republika e Serbisë<sup>1</sup>.
3. Drejtorja për të Burgosurit dhe Zhdukurit e Ministrisë së Veteranëve Kroat të Republikës së Kroacisë do të mbështesë dhe do të marrë pjesë në zbatimin e Planit të Përbashkët Kornizë dhe do të ketë, gjithashtu, në bazë të statusit të saj si një shtet anëtar të BE, një rol këshillëdhënës për çështjet e personave të zhdukur që janë të lidhura me pranimin në BE të anëtarëve të tjerë të GPZH.

### **I. QËLLIMI**

4. Të intensifikohet bashkëpunimi shumëpalësh për të kërkuar dhe identifikuar personat e zhdukur si rezultat i konflikteve në territorin e ish-Jugosllavisë të viteve 90-të.

### **II. KOMPONENTËT E PLANIT TË PËRBASHKËT KORNIZË**

#### **2.1. Veprimi për të zgjidhur rreth 4,000 rastet NN pa emër, apo të paidentifikuar në të gjithë territorin e ish-Jugosllavisë**

5. Ka më shumë se 4,000 raste NN të ruajtura në morgjet në territorin e ish Jugosllavisë. Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) ka nxjerrë profilet e ADN-së për më shumë se 3,000 nga rastet NN; megjithatë këto nuk përputhen me asnjë nga setet e mostrave referuese të mbledhura nga familjet të cilat akoma janë në kërkim të të afërmeve të tyre të zhdukur. Edhe pse disa nga 4,000 rastet NN kanë qenë subjekt i ekzaminimeve antropologjike-mjekoligjore dhe testimit të ADN-së në vitet e shkuara, vazhdon nevoja për të siguruar zgjidhjen e çështjes së NN.
6. GPZH do të hartojë projekte pilot për të trajtuar rastet NN dhe identifikimet e mundshme të gabuara, bazuar në përvojën e deritanishme dhe praktikat më të mira duke marrë parasysh nevojat specifike të anëtarëve të GPZH.
7. Pilot projektet mund të përfshijnë disa apo të gjitha aktivitetet e poshtshënuara.

---

\* Ky shënim është Pa paragjykim për pozicionin e palëve për statusin, në përputhje me 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

<sup>1</sup> IV janë: Instituti i Personave të Zhdukur i Bosnjës dhe Hercegovinës, Drejtorja për të Burgosurit dhe Zhdukurit e Ministrisë së Veteranëve Kroat të Republikës së Kroacisë, Komisioni i Kosovës për Persona të Zhdukur, Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur i Malit të Zi, Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur i Republikës së Serbisë.

- Ndarjen e identifikimeve sipas atyre të bëra në bazë të analizës së ADN-së dhe ato të bëra duke përdorur metoda tradicionale të identifikimit të supozuar, nëse kjo tashmë nuk ka përfunduar;
  - Shqyrtimi i dokumenteve të rasteve të mbyllura duke përdorur metodat tradicionale të identifikimit. Ky rishikim do të përfshinte një analizë të gërmimeve të mëparshme nga të cilat u zharrosën mbetjet njerëzore dhe disa u identifikuan me mjete tradicionale ndërsa të tjerat mbeten të pidentifikuara (NN);
  - Një rishikim gjithëpërfshirës - duke përfshirë ekzaminimin mjeko-ligjor - të mbetjeve të pidentifikuara në mjediset e morgjeve për të përcaktuar numrin e rasteve të pidentifikuara dhe për të siguruar që mostrat post mortem janë marrë për testimin e ADN-së;
  - Mbledhja e mostrave referuese shpesh të ADN-së nga anëtarët e familjes së të zhdukurve që më parë i mbyllën rastet e tyre pa ndihmën e analizës së ADN-së në rast dyshimi për rezultatet e identifikimeve të bëra duke përdorur metoda tradicionale të identifikimit. Përpjekjet e grumbullimit të mostrave referuese do të marrin formën e pilot projekteve dhe do të synojnë anëtarët e familjes që tradicionalisht kanë identifikuar të afërmit e tyre, të cilët janë zharrosur nga varrezat dhe prej të cilave janë gjetur edhe raste të zharrosura që mbeten të pidentifikuara.
8. Këto pilot projekte mund të çojnë deri tek identifikimet e reja dhe zvogëlimi i rasteve NN. Në këtë kontekst, do të vazhdojë zbatimi i Projektit të Përbashkët mbi identifikimet e drejtuara nga ADN-ja ndërmjet Drejtorisë për të Zhdukurit dhe Burgosurit të Ministrisë së Veteranëve Kroat të Republikës së Kroacisë dhe KNPZH-së.

## **2.2. Shkëmbimi i të dhënave për rastet e personave të zhdukur ndërmjet IK dhe familjeve të të zhdukurve me anë të "Bazës së të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish\_Jugosllavisë" në vitet 90**

9. Anëtarët e GPZH do të:
- a. Përditësojnë të dhënat për rastet e personave të zhdukur, dmth. rastet e hapura dhe të myllura përmes "Bazës së të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish\_Jugosllavisë" (Baza e të Dhënave) në përputhje me konkluzionet nga takimi i Podgoricës më 25-26 maj 2018 dhe takimeve tjera konsultative të mbajtura në të kaluarën;
  - b. Heqin dokumentet e dubluara për rastet e personave të zhdukur nga Baza e të dhënave;
  - c. Sigurojnë funksionimin e Grupit Operacional të Punës i cili do t'i shqyrtojë rregullisht rastet e personave të zhdukur me interes të përbashkët<sup>2</sup> në bazën e të dhënave;
  - d. Shtimi i përmbajtjes së bazës së të dhënave, kur është e domosdoshme, duke shtuar dokumente shpesh që lidhen me regjistrimin e verifikuar të rasteve të personave të zhdukur dhe të cilat mund të ndihmojnë në kërkimin e personave të zhdukur. Dokumentet shpesh do të jenë të disponueshme vetëm për IV-të.
10. Pasi verifikohen të dhënat në kuadër të bazës së të dhënave dhe me pëlqimin e përbashkët të të gjitha IV, kategoritë e zgjedhura të të dhënave nga baza e të dhënave do të vendosen në domenin publik.

---

<sup>2</sup> Rastet me interes të përbashkët janë ato të cilat janë relevante për më shumë se një anëtarë të GPZH.

### **2.3. Shkëmbimi I informacioneve për lokacionet potenciale të vendvarrezave të jashtëligjshme dhe ndërmarra e gërmimeve të përbashkëta**

11. IV do të bëjnë përpjekje për të patur qasje në informata që mund të jenë relevante për gjetjen e varrezave klandestine brenda arkivave të tyre dhe do të raportojnë për progresin tek IV tjera brenda GPZH.
12. Gjurmuesi i vendvarrimeve i ICMP mund të përdoret si një mjet për shkëmbimin e informacionit rreth vendndodhjeve të varrezave të mundshme.
13. IV do të sigurojnë një shkëmbim të informacionit që ka të bëjë me gërmimet e varrezave me interes të ndërsjelltë.
14. IV përpiqen të sigurojnë zhvarrosjen në kohë të varrezave.

### **2.4. Angazhimi i familjeve të të zhdukurve në proces**

15. IV do të sigurojnë angazhimin e familjeve të të zhdukurve duke siguruar përditësime të rregullta për përpjekjet e tyre të përbashkëta për të kërkuar dhe identifikuar personat e zhdukur në takimet e përbashkëta rajonale me përfaqësuesit e shoqatave të familjeve të personave të zhdukur.

### **2.5. Organizimi i përkujtimeve të përbashkëta për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve**

16. Me iniciativën e shoqatave të familjeve të personave të zhdukur në territorin e ish Jugosllavisë, IV mund të organizojnë çdo vit përkujtime të përbashkëta për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve - 30 Gusht.

## **III. ZBATIMI DHE RAPORTIMI**

17. Anëtarët e GPZH do të takohen së bashku të paktën dy herë në vit për të monitoruar dhe raportuar mbi progresin në aktivitetet e lartpërmendura.
18. Anëtarët e GPZH me ndihmën teknike të ICMP, do të hartojnë një raport vjetor mbi zbatimin e Planit të përbashkët Kornizë dhe aktiviteteteve tjera të cilat kanë të bëjnë me procesin e kërkimit dhe identifikimit të personave të zhdukur. Me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të GPZH, ICMP mund të paraqesë raportin në Samitin e Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor.

## **IV. MONITORIMI**

19. Koordinimi Rajonal i Shoqatave të Familjeve të të Zhdukurve nga ish Jugosllavia, një organizatë e shoqërisë civile, e cila mbledh përfaqësuesit e shoqatave të ndryshme familjare do të monitorojë zbatimin e Planit të Përbashkët Kornizë.

## **V. ROLI i ICMP**

20. ICMP do të ndihmojë GPZH në zbatimin e Planit të Përbashkët Kornizë përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Sigurimi i qasjes së pandërprerë në testimin e ADN-së dhe përputhjen e mostrave biologjike me qëllim të identifikimit njerëzor të personave të zhdukur;
- Mbajtja e një "Baze të Dhënash për Rastet Aktive të Personave të Zhdukur nga Konfliktet në ish-Jugosllavi", në mënyrë që të sigurohet që të dhënat mbi rastet aktive të shkëmbehen në mënyrë të sigurt dhe transparente midis institucioneve vendore përgjegjëse për procesin e personave të zhdukur;
- Sigurimi i asistencës teknike për të zgjidhur NN dhe rastet e keqidentifikuara;
- Sipas nevojës, mbështetja e gërmimeve të mbetjeve mortore me interes të përbashkët në përputhje me legjislacionin pozitiv të anëtarëve të GPZH-së në territorin e së cilës bëhet gërmimi;
- Lehtësimi i takimeve të rregullta shumëpalëshe të GPZH për të rritur koordinimin e zbatimit të Planit të përbashkët kornizë. Modeli i rotacionit gjatë organizimit të takimeve do të aplikohet;
- Zhvillojë kapacitetet vendore në kuptimin e testimit me ADN të mostrave biologjike post mortem;
- Mundësojë IV-ve qasje në bazën e të dhënave gjenetike të ICMP me anë të një moduli online për përputhjen me qëllim të identifikimeve njerëzore.

## **VI. PËRKRAHJA FINANCIARE**

21. BE-ja dhe Britania e Madhe kanë premtuar fonde për ICMP-në të cilat ICMP do të përdorë për të lehtësuar GL dhe për të ofruar ndihmë teknike për GPZH në zbatimin e Planit të Përbashkët Kornizë. ICMP do të vërë në dispozicion të GPZH raportin e auditimit financiar.

**SHËNIM SQARUES I**  
**DRAFT PLANIT KORNIZË PËR ADRESIMIN E ÇËSHTJES SË PERSONAVE TË ZHDUKUR NGA**  
**KONFLIKTET NË TERRITORIN E ISH JUGOSLLAVISË**

**I. HISTORIKU**

1. Për më shumë se njëzet vjet, pjesëmarrësit e Procesit të Berlinit nga Ballkani Perëndimor dhe Republika e Kroacisë, që janë prekur nga çështja e personave të zhdukur si pasojë e konflikteve në ish-Jugosllavi të viteve 90-të, kanë bërë një përpjekje të konsiderueshme për të përmbushur detyrimin për të kërkuar dhe identifikuar personat e zhdukur. Ata kanë krijuar institucione të dedikuara, kanë krijuar korniza ligjore dhe kanë zhvilluar kapacitete teknike për të dhënë përgjigje për të zhdukurit.
2. Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre përpjekjeve, më shumë se 70 për qind të 40,000 personave që mungonin në fund të konflikteve të armatosura, janë gjetur, një rezultat që nuk është arritur askund në botë.
3. Pavarësisht këtij progresi, 12,000 persona ende mungojnë në të gjithë rajonin. Prandaj është thelbësore që përpjekjet të intensifikohen dhe të rriten të gjitha aspektet e bashkëpunimit rajonal që janë kyç për gjetjen dhe identifikimin e një numri më të madh të personave të zhdukur.
4. Për shkak të natyrës së ndërlidhur të konflikteve të viteve 1990, nuk është e pazakontë të gjendet se varrezat klandestine janë të vendosura në territorin e një anëtarit të Grupit për Personat e Zhdukur (GPZH), familjet e të zhdukurve qëndrojnë në një tjetër dhe të dhënat që i përkasin kërkimit janë tek një anëtar i tretë i GPZH. Adresimi i çështjes në mënyrë efektive kërkon bashkëpunimin e zgjeruar shumëpalësh.

**II. RREZULTATET E TAKIMIT TË PODGORICËS**

5. Me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) organizoi një takim në Podgoricë me Institucionet Vendore (IV) përgjegjëse për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur në maj 2018. Në atë takim, pjesëmarrësit mbështetën miratimin e një Plani të Përbashkët Kornizë që synon të ndërtohet bazuar në arritjet e deritanishme dhe duke adresuar pengesat në llogaridhënjen e 12,000 personave që ende mungojnë në territorin e ish-Jugosllavisë. IV shprehën mbështetje për përpjekjet për të përmirësuar bashkëpunimin multilateral nëpërmjet zhvillimit të një Plani Kornizë, i cili do të bazohet në marrëveshjet dypalëshe ekzistuese dhe mekanizmat e bashkëpunimit. ICMP do të ofrojë asistencë teknike në zbatimin e Planit të Përbashkët Kornizë, siç kërkohet.
6. Duke dëshiruar të kontribuojnë në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur, Republika e Kroacisë, si një anëtare e plotë e Bashkimit Evropian që ka arritur standarde ndërkombëtare në procesin e kërkimit të personave të zhdukur, do të mbështesë zbatimin e Planit Kornizë me pjesëmarrjen e saj në punën e GPZH.

**III. Komponentët e planit të përbashkët kornizë**

**3.1. Veprimet për të zgjidhur rreth 4,000 rastet "pa emër" (pa emër, ose të paidentifikuar**

## **NN) dhe raste të keqidentifikuara në të gjithë territorin e ish-Jugosllavisë**

7. Para prezantimit të testimi të ADN-së për identifikimin e personave të zhdukur në vitin 2001 në territorin e ish Jugosllavisë, rastet u identifikuan kryesisht me anë të njohjes vizuale të mbetjeve njerëzore, efektet personale dhe rrobat (Metodat tradicionale të identifikimit) dhe në Republikën e Kroacisë duke përdorur edhe krahasimin Ante mortem dhe Post Mortem. Metodat tradicionale të identifikimit nuk janë të sakta dhe mund të bartin rrezik gabimi. Çdo identifikim i gabuar potencial mund të jetë pengesë për zgjidhjen e rasteve të mbetura aktive të personave të zhdukur.
8. Ekzaminimi dhe identifikimi i mbetjeve njerëzore në Republikën e Kroacisë kryhen nga laboratorët e Republikës së Kroacisë, pjesërisht përmes bashkëpunimit me ICMP në Projektin e Përbashkët të Identifikimit.

### **3.2. Shkëmbimi i të dhënave për rastet e personave të zhdukur ndërmjet IV dhe familjeve të të zhdukurve përmes “Bazës së të Dhënave të Rasteve Aktive të Personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë”**

9. ICMP nisi krijimin e “Bazës së të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në ish Jugosllavi” (më poshtë Baza e të dhënave) para disa vitesh, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit rajonal përmes shkëmbimit transparent të të dhënave për rastet aktive të personave të zhdukur. Projekti u bazua në faktin se konfliktet e armatosura në territorin e ish Jugosllavisë ishin të ndërlydhura dhe se rastet e personave të zhdukur u raportuan tek autoritetet e dy apo më shumë anëtarëve të GPZH. U kuptua nevoja për shkëmbim dhe krahasim të listave dhe krijimin e të dhënave të unifikuara të personave akoma të zhdukur.
10. Në 2016 dhe 2017, ICMP-ja bëri marrëveshje me IV të për të marrë pjesë në krijimin e një bazë të dhënash për rastet aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë. Deri në fund të vitit 2017, të gjitha IV kishin dërguar tek ICMP të dhënat e tyre për rastet aktive të personave të zhdukur.
11. Projekti u krijua nën patrotanin e ICMP përmes një serie prej 9 takimeve konsultative të IV. Në takimin e fundit të mbajtur në Beograd në dhjetor të vitit 2017, ICMP prezantoi versionin e parë punues të bazës së të dhënave.
12. Baza duhet të nxisë shkëmbimin transparent të informatave në kohë reale, heqjen e dublikimeve dhe të dhënave të shumfishta dhe detaje për rastet me interes të përbashkët<sup>3</sup> për më shumë se një pjesëmarrës. ICMP mirëmban këto të dhëna në serverat e tij dhe në bazë të reciprocitetit secili nga IV mund të shqyrtojë të dhënat e parashturara nga pjesëmarrësit tjerë.

### **3.3. Shkëmbimi i informacionit mbi vendet e mundshme të varrezave klandestine, dhe pjesë marrja në gërmimeve me interes të përbashkët**

13. Siç është theksuar tashmë, konfliktet e armatosura që ndodhën në ish-Jugosllavi çuan në lëvizje të konsiderueshme të popullsisë brenda territorit të ish Jugosllavisë. Në shumë raste, personat e raportuar të zhdukur nga një rajon u vranë ose u zhdukën në një tjetër. Si rezultat, varret klandestine mund të përmbajnë mbetje të viktimave të raportuara të zhdukur në një vend tjetër

---

<sup>3</sup> Rastet me interes të përbashkët janë personat të cilët janë zhdukur në territorin e një vendi dhe familja e të cilit banon në territorin e tjetrit.

nga vendndodhja e varrit.

14. Marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit dypalësh përsërisin nevojën për të rritur bashkëpunimin në rritjen e transparencës së zhvarrimeve në vende që mund të jenë me interes të ndërsjellë dhe të krijojnë mekanizma për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni. Këto dispozita ende duhet të zbatohen në tërësinë e tyre.

#### **3.4. Angazhimi i familjeve të të zhdukurve në proces**

15. Familjet e të zhdukurve ndajnë një përvojë të përbashkët të humbjes dhe një shkallë të mirëkuptimit të ndërsjellë - askush tjetër nuk mund të kuptojë më mirë ndjenjën e humbjes së përjetuar nga ata që kanë një të afërm të humbur. Prandaj, shoqatat e familjes që funksionojnë në territorin e ish-Jugosllavisë e kanë njohur nevojën për bashkëpunim shumëpalësh dhe veprime të përbashkëta për të siguruar që autoritetet të mbeten të angazhuara në këtë çështje. Koordinimi rajonal i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga ish-Jugosllavia mbledh 17 shoqata dhe rrjete të shoqatave. Gjatë periudhës së kaluar, shoqatat e mbledhura rreth Koordinimit Rajonal kanë mbështetur dhe kanë ndërtuar momentin për krijimin e institucioneve të përkushtuara përgjegjëse për çështjen e personave të zhdukur dhe janë të etur të sigurojnë që familjet e personave të zhdukur të kenë qasje më të mirë në punën e këtyre institucioneve. Përveç kësaj, ata synojnë të veprojnë si një urë midis institucioneve dhe familjeve duke ofruar platformë për shkëmbimin e informacionit, e cila do të sigurojë një shkallë më të lartë të transparencës në proces.

#### **3.5. Organizimi i përkujtimeve të përbashkëta për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve**

16. Përkujtimet e përbashkëta shërbejnë për të shprehur nderime të respektueshme për personat e zhdukur si rezultat i konflikteve në ish-Jugosllavi për të rritur ndërgjegjësimin për dimensionin njerëzorë të tragjedisë së personave të zhdukur dhe familjeve të tyre dhe penguar politizimin e saj.

### **IV. RAPORTIMI**

17. Samitet e Procesit të Berlinit janë platformë për GPZH që të raportojnë për progresin në zbatimin e planit kornizë dhe aktivitetet tjera në lidhje me kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur. Kjo do të sigurojë dukshmëri dhe transparencë të punës si dhe do të ndihmojë në pëndrueshmërinë e rezultateve.

### **V. MONITORIMI**

18. Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile dhe veçanërisht familjeve të të zhdukurve në procesin e kërkimit dhe identifikimit të të zhdukurve është thelbësore. Familjet e të zhdukurve, si bartës të drejtave, mund të luajnë një rol kyç në drejtim të monitorimit të veprimeve të IV në kryerjen e detyrave të tyre.

## **VI. ROLI I ICMP**

19. Që nga viti 1996, ICMP ka ofruar udhëzime në politikat dhe ndihmë teknike në kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur.
20. Bashkëpunimi i ICMP-së me BH-në bazohet në Marrëveshjen e saj të Zyrës në BH të lidhur me Këshillin e Ministrave të BiH në vitin 1998. Përveç kësaj, ICMP dhe Këshilli i Ministrave të BiH nënshkruan në vitin 2005 një Marrëveshje për marrjen e rolit të bashkë-themeluesit të Instituti i Personave të zhdukur të Bosnjës dhe Hercegovinës.
21. Bashkëpunimi i ICMP me Kroacinë bazohet në Marrëveshjen e Zyrës, e cila u nënshkrua në vitin 2002, marrëveshja për një Projekt të Përbashkët mbi identifikimin e ADN-së, e cila u nënshkrua në 2004. Në janar 2017, Kroacia dhe ICMP nënshkruan një marrëveshje mbi pjesëmarrjen e Kroacisë në projektin: “Baza e të dhënave rasteve Aktive të Personave të Zhdukur nga Konfliktet e Armatosura në ish-Jugosllavi”.
22. Bashkëpunimi i ICMP me Kosovën\* rrjedh nga një marrëveshje që ICMP nënshkroi me Misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK) në 2003. Që nga viti 2008, ICMP ka bashkëpunuar me EULEX në bazë të asaj marrëveshjeje dhe ka vazhduar përkrahjen për institucionet përgjegjëse për personat e zhdukur dhe institucionet e tjera.
23. Bashkëpunimi i ICMP me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur të Malit të Zi rrjedh nga marrëveshjet e nënshkruara me Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ) në vitin 2001.
24. Bashkëpunimi i ICMP me Serbinë është i bazuar në disa marrëveshje që datojnë që nga 2001. Marrëveshja e parë e bashkëpunimit teknik u nënshkrua në vitin 2001 me Ministrinë e Punëve të Jashtme të RFJ-së. Në vitin 2014 ICMP nënshkroi një marrëveshje me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur të Republikës së Serbisë në lidhje me testimin e ADN-së dhe përputhjen e mostrave biologjike me qëllim identifikimin e personave të zhdukur. Në vitin 2017, Republika e Serbisë ratifikoi Marrëveshjen ndërkombëtare për Statusin dhe Funksionet e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur dhe në këtë mënyrë iu bashkua Konferencës së shteteve të ICMP-së.